



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 23.11.2018

Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Besnik Cani.</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z.Besnik Cani</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Prokuror në Prokurorinë e Elbasanit, kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor që ajo të shtyhej për shqyrtim të mëtejshëm.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmblodhur)	<i>Në fund të seancës dëgjimore trupi gjyqësor u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën vetëm për shpalljen e tij në datën 27.11.2018, ora 11:00.</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Tupa gjykyese (emrat)	<i>Kryesues: Olsi Komici, Relator: Lulzim Hamitaj, Anëtar: Brunilda Bekteshi</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (OMN): zj. Mia Raising.</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Subjekti i rivlerësimit u paraqit pa praninë e një mbrojtësi ligjor (Avokat)</i>
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Amilda Celami</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u lejuan media, qytetarë të rastësishëm, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, si dhe kushdo që mund të ishte i interesuar. Numri total i të pranishmëve varioje 15-20 persona.</i>
Media e pranishme:	<i>Gazetarë dhe operatorë të mediave ishin të pranishëm.</i>

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	<i>Më 21.07.2018 KPK kishte mbyllur hetimin vetëm për kriterin e pasurisë. Ndërsa më 07.09.2018 ka vendosur për gjykimin mbi 3 kriteret.</i>	<i>KPK ka parë të arsyeshme fillimisht mbylljen e hetimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.</i>	<i>Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin mbi tre kriteret me anë të kërkesave të njëpasnjëshme drejtuar KPK-së.</i>

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Raporti i ILDKPKI-së pasqyron: 1) Ap.banimi 117m2, 2) Truall 662m2 dhe ndërtesë 112m2, 3)Truall 363m2, 4) Garazh, 5) Autoveture "Benz" 2006	Raporti nga ILDKPKI	Lidhur me gjykimin e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës, aftësive profesionale, relatori i çështjes, pohoi se hetimi ishte bazuar në të dhënat e ardhura nga ILDKPKI, DSIK, raporti nga grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, hetimi administrativ i KPK-së, të dhënat e marra nga institucionet publike dhe nga shpjegimet e bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në bazë të rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit i ishte kërkuar të japë shpjegime/prova, bazuar në nenin 52 të ligji 84/2016.
	Në bazë të hetimit të thelluar të KPK-së: 1) Lidhur me ndërtesën mbi truallin 662m2 (Paskuqan, Tiranë) rezultojnë ndërtim pa leje, i palegalizuar. Subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumenta të ardhurat për krijimin e saj. 2) Kontratë qeraje me shoqërinë "K" sh.p.k për truallin 662m2. Në këtë kontratë parashikohet ndërtimi i një karburanti, lokali dhe lavazhi. Subjekti do të përfitonte 5 lekë për cdo litër naftë të shitur. Lokali dhe lavazhi administrohen nga djali i tij ndryshe nga çfarë parashikohet në kontratë. KPK ka dyshime se kjo kontratë është në kundërshtim me figurën e subjektit. 3) Ap. Banimi 117m2 , burimi i të ardhurave 3500 \$ të mbartura nga viti 2004, të padeklaruar, 6 000 euro hua, 150 000 tërheqje shumë nga depozita dhe kursime. KPK, ngriti dyshime për kursimet e vitit 2005. 4) Analiza financiare për vitet 2005, 2006, 2010, 2015 rezultojnë me bilanc negativ – 81 912 lekë.	Relatori i çështjes	
		Mbrojtja	
	Lidhur me ndërtesën në zonën e Paskuqanit, subjekti ka theksuar se është ndërtuar në vitet 1993-1994, ndërtuar me argat, prandaj nuk disponon dokumentacion lidhur me shpenzimet. Subjekti ka deklaruar se analiza financiare e 6 viteve, nuk përputhet me shpenzimet e bëra në realitet dhe llogaritja nuk është bërë në mënyrën e duhur. Lidhur me kontratën e qerasë me shoqërinë "K" sh.p.k konstatoi se nuk e njeh shumë mirë të drejtën civile, "Kemi rënë dakort që unë do të isha pronari dhe shoqëria do të bënte ndërtimet" shprehet ai. Marrëveshja e fillimit ishte që subjekti t'i jepte ½ e qerasë, më pas po me marrëveshje është lënë që subjekti të përfitonte 5 lekë/litër. Lidhur me kredinë e butë, e aplikuar nga bashkëshortja, por që nuk është marrë, thjeshtë ajo ka fituar statusin si e pastrehë. Ai përmend faktin se edhe një subjekt tjetër i cili e ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit ka marrë kredi të butë dhe nuk është trajtuar si e paligjshme nga ana e KPK-së.	Subjekti	
	Rezultojnë ankesa për korrupsion, shpërdorim detyre.	Ankesa nga publiku	
Mia Raising i drejtoi disa pyetje subjektit lidhur me kredinë e butë të aplikuar nga bashkëshortja e tij. A ka qënë subjekti në dijeni të këtij fakti apo bashkëshortja ka aplikuar pa dijeninë e tij? Pavarësisht njohjes me ligjin a ishin interesuar nëse plotësonin kriteret për ta përfituar apo jo?	ONM		
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Raporti i DSIK rekomandon: Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.	Të dhëna nga raportet e DSIK	
	Relatori i çështjes pohoi se lidhur me figurën e z.Cani kishin ardhur disa denoncime për korrupsion dhe kontakte me krimin e organizuar	Relatori	
		Mbrojtja	

		Subjekti	
	6 ankesa	Ankesa nga publiku	
		ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Raporti nga grupi i punës në Prokurorinë ë Përgjithshme: e ka cilësuar z.Cani me vlerësime pozitive dhe të pranueshme lidhur me aftësitë profesionale, etikën, korrektësinë në punë.	Të dhëna nga Prokuroria e Përgjithshme për prokurorët	
	Nga hetimi I thelluar i bërë nga KPK ka rezultuar se një prej dosjeve të marra në shqyrtim ka qënë problemtike , gjë e cila nuk është pasqyruar në raportin e grupit të punës. Ndaj subjektit janë ngritur dyshime lidhur me disa dosje, si ajo për mos-hetimit te kryebashkiakut të Fierit për përfshirje në skemë korruptive, pushimi i hetimeve për tenderat në spitalin Psikiatrik të Elbasanit. Gjithashtu ndaj subjektit të rivlerësimit ka pasur denoncime për kontakte të papërshtatëshme dhe korrupsion.	Relatori	
		Mbrojtja	
		Subjekti	
E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z.Besnik Cani, prokuror pranë Prokurorisë së Elbasanit, u paraqit e rregullt, duke respektuar kriteret për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Pati kontestime, pyetje nga anëtarët e trupës gjyquese, përfaqësuesja e ONM, kundërshtime nga subjekti i rivlerësimit. Gjatë shqyrtimit të seancës dëgjimore u trajtuan tre kriteret e gjykimit të procesit të rivlerësimit. z.Cani pohoi se ishte njohur dhe kishte marrë në dorëzim materialet e dosjes. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore dhe me provat e paraqitura, subjekti ska mundur të provojë në mënyrë të dokumentuar krijimin e disa pasurive, pasi sipas tij janë krijuar në një periudhe kur informaliteti ka qënë I lartë. Subjektit të rivlerësimit I është kaluar barra e provës dhe trupi gjykues pohoi që ishin marrë në shqyrtim provat e sjella . Subjektit gjatë zhvillimit të seancës iu desh të përballej me pyetje nga trupi gjykues dhe përfaqësuesja e ONM kryesisht lidhur me kriterin e pasurisë. Ndaj tij ishin adresuar disa ankesa, të cilat relatorja e cështjes I trajtoi në mënyrë të detajuar. Dënoncimet ishin me natyrë korruptive dhe shpërdorim detyre. Trupi gjykues në asnjë moment nuk shkeli rregullat e etikës, profesionalizmit dhe nuk u vërejtën probleme të kësaj natyre. Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të mos kishte mbrojtës por nuk u konstatua cënimi i së drejtës për mbrojtje efektive nga ana e trupit gjykues si dhe nuk pati pretendime nga ana e subjektit. Nuk u konstatua asnjë shkelje, paragjykim apo presione të ndryshme gjatë seancës. Në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore u lejuan media, gazetarë, qytetarë të rastësishëm, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit te rivlerësimit si dhe kushdo qe ishte i interesuar. Përmasat e sallës në pallatin e Koncerteve (ish pallati I Kongreseve) garantonte respektimin e plotë të standarteve të një seance publike.		